UDHËZIM
Nr. 217, datë 2.11.2022

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË LËSHIMIT TË FORMËS, ELEMENTEVE TË SIGURISË DHE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË LEJES SË TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 8, të ligjit nr. 24/2022, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit",

UDHËZOJ:

I. PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT PËR LEJE TË TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT

1. Leje e Trafikut Lokal të Kufirit nënkupton një dokument të veçantë, i cili lejon banorët e zonës kufitare të kalojnë kufirin shtetëror dhe të qëndrojnë në zonën kufitare, siç përcaktohet në Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, "Për regjimin e trafikut lokal të kufirit në zonat kufitare ndërmjet kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës".

2. Leja e Trafikut Lokal Kufitar jepet brenda një aftati prej 5 ditëve pune, nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin (DVKM Kukës), nga parashtrimi i kërkesës.

3. Në rast refuzimi, brenda të njëjtit i kthehet përgjigje shtetasit, duke i sqaruar arsyen e refuzimit.

4. Ankimi administrativ ndaj aktit të refuzimit të paraqitet brenda 30 ditëve, nga data kur shtetasi ka marrë njoftim për refuzimin e lëshimit të lejes, pranë Autoritetit Vendor për Kufirin dhe Migracionin ose organit epror të tij.

5. Kur Autoriteti Vendor për Kufirin dhe Migracionin vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, atëherë ai miraton lëshimin e lejes.

6. Kur Autoriteti Vendor për Kufirin dhe Migracionin vlerëson se ankimi nuk është i pranueshëm dhe plotësisht i bazuar, atëherë e përcjell atë për shqyrtim dhe vendimmarrje tek organi epror, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse të dosjes dhe një raport me shkrim të qëndrimit të tij.

7. Nëse organi epror vlerëson se refuzimi është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që ka dhënë autoriteti vendor apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai refuzon ankimin dhe paraqet arsyetimin e ri.

8. Në rast se organi epror vlerëson se ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, ai vendos përfundimisht mbi lëshimin e lejes së kërkuar nga shtetasi.

9. Lëshimi i dokumentit Leje e Trafikut Lokal të Kufirit për shtetasit e zonës kufitare, nuk ka kosto financiare për shërbimin dhe përfitimin e dokumentit.

10. Banorët e zonës kufitare, të cilët janë të pajisur me dokumentin Leje e Trafikut Lokal të Kufirit të vlefshme për qarkullim në zonat kufitare, mund të udhëtojnë dhe të qëndrojnë në zonën kufitare.

11. Pritja dhe shqyrtimi i aplikimeve nga punonjësi i autorizuar do të bëhet nëpërmjet sistemit të menaxhimit të aplikimeve Application Management System (AMS).

12. Sistemi AMS jep mundësinë e pritjes të aplikimeve *online,* që realizohet nëpërmjet portalit *e-Albania*, marrjen në shqyrtim të tyre dhe aksesimin e dokumenteve që ngarkohen për aplikimin specifik, përcjelljen në hallkat e mëtejshme, sipas *workflow* specifik për Autoritetin që akseson sistemin.

13. Aplikimet priten nga punonjësit i autorizuar i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionit (DVKM Kukës).

14. Shërbimi për aplikimin dhe miratimin e dokumentit të lejes së kalimit lokal të kufirit, kryhet nga zyra që aktualisht pret aplikimet për dokumentin "Leje qëndrimi".

15. Pritja dhe shqyrtimi i aplikimeve implementohen, sipas përgjegjësive funksionale dhe linjës hierarkike specialist-përgjegjës-drejtor-titullar institucioni.

II. APLIKIMI PËR LEJE TË TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT

1. Aplikimi për leje të trafikut lokal të kufirit bëhet nga shtetasi i interesuar i zonës kufitare, të përcaktuar në marrëveshjen dypalëshe, pas identifikimit në platformën *e-Albania* dhe zgjedhjes së shërbimit Leje e Trafikut Lokal të Kufirit.

2. Në vijim, shtetasi plotëson formularin e aplikimit për leje të trafikut lokal të kufirit në Republikën e Shqipërisë.

3. Formulari i aplikimit për leje të trafikut lokal, përbëhet nga tri rubrika:

a) deklarime;

b) seksioni A;

c) seksioni B.

4. Formulari i aplikimit plotësohet me të dhëna reale dhe të sakta nga shtetasit, pasi informacioni jo i plotë vonon përpunimin e aplikimit dhe mund të çojë në refuzimin e tij.

5. Udhëzimet për plotësimin e formularit mund të lexohen në faqen zyrtare të Policisë së Shtetit.

6. Dokumentet që duhet të bashkëngjitë shtetasi të shënuara në seksionin A të formularit janë:

a) fotokopje e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit (pasaportë, kartë identiteti);

b) një fotografi (47mm x 36mm), të bërë jo më përpara se 6 muaj nga data e aplikimit;

c) deklaratë individuale mbi motivin e kalimit dhe qëndrimit në zonën kufitare;

d) deklaratë/autorizim (për rastin kur aplikimi bëhet nga personi i autorizuar);

e) dokumente të tjera (fushë jo e detyrueshme).

7. Seksioni B i formularit plotësohet nga punonjësi i policisë i autorizuar që pranon aplikimin.

III. MËNYRA E FUNKSIONIMIT DHE E PËRFITIMIT TË LEJES SË TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT

1. Kërkesa për shërbimin Leje Trafiku Lokal të Kufirit, kryhet përmes platformës *e-Albania*, nga ana e shtetasit të interesuar që është banor i zonës kufitare.

2. Pas identifikimit në platformë, shtetasi zgjedh shërbimin Leje Trafiku Lokal të Kufirit.

3. Aplikimi realizohet vetëm pasi të plotësohen fushat, si dhe të ngarkohet dokumentacioni kërkuar.

4. Sistemi pasqyron të dhënat e aplikantit në kohë reale, referuar Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

5. Foto e ngarkuar nga aplikanti, si pjesë e dokumentacionit, gjendet e stampuar në dokumentin përfundimtar Leje Trafiku Lokal të Kufirit.

6. Aplikimi nëpërmjet sistemit AMS mbërrin në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin.

7. Punonjësi i autorizuar për shqyrtimin e aplikimeve në strukturat e Policisë së Shtetit, bashkëlidhur gjen dokumentacionin e ngarkuar nga aplikanti, si edhe formularin me të dhënat e detajuara.

8. Krahas adresës së pasqyruar, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile, formulari pasqyron edhe adresën e deklaruar nga qytetari.

9. Punonjësi i autorizuar bën verifikimin, nëse adresat përputhen me njera tjetrën, me qëllim identifikimin e pasaktësive në deklarimin e aplikantit.

10. Punonjësi i autorizuar kryen të gjitha verifikimet e nevojshme dhe përgatit dokumentin përfundimtar për miratimin ose jo të Leje Trafiku Lokal të Kufirit.

11. Dokumenti përfundimar nënshkruhet elektronikisht nga Drejtori i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin.

12. Pas miratimit dhe nënshkrimit, dokumenti Leje Trafiku Lokal të Kufirit i dërgohet shtetasit si kthim përgjigje nga punonjësi i autorizuar në strukturat e Policisë së Shtetit, nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQDNE).

IV. ELEMENTET E SIGURISË SË LEJES TË TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT

1. Dokumenti përfundimtar Leje Trafiku Lokal të Kufirit nënshkruhet nga Autoriteti Vendor për Kufirin dhe Migracionit me nënshkrim elektronik.

2. Në çdo rast të kalimit kufitar, shtetasi është i detyruar të paraqesë këtë dokument në formën elektronike, në mënyrë që të jetë e verifikueshme vërtetësia e dokumentit.

3. Dokumenti i paraqitur në formën elektronike, ka numrin serial përkatës dhe ruan vlefshmërinë e nënshkrimit elektronik, i cili është një element i rëndësishëm sigurie.

V. FORMA DHE MODELI I LEJES TË TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT

1. Forma dhe modeli i Leje Trafiku Lokal të Kufirit, i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

VI. PËRMBAJTJA E LEJES SË TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT

1. Leje Trafiku Lokal të Kufirit është dokumenti në formatin A4, i cili i dërgohet shtetasit si kthim përgjigje nga specialisti i autorizuar në strukturat e Policisë së Shtetit, nëpërmjet Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE).

2. Leje Trafiku Lokal të Kufirit përmban të gjitha të dhënat, si: portreti, nënshkrimi dhe të dhënat alfanumerike: emër, mbiemër, shtetësia, vendlindja, datëlindja, data e lëshimit, data e skadimit, nr. i lejes së kalimit, gjinia, autoriteti lëshues, adresa e banimit, zona kufitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

Aneksi Nr. 1

.....

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin_____

LEJE E KALIMIT KUFITAR LOKAL
LOCAL BORDER TRAFFIC PERMIT
Seria dhe Numri i Lejes
Series and Permission Number
BG 239200

EMRI (AT), MBIEMRI _____
Firs name (s), Family name

Foto
Photograph

VENDLINDJA _____ DATËLINDJA dd.mm.yy
Place of birth *Date of birth*

SHTETËSIA _____ GJINIA _____
Nationality *Sex*

NUMRI I PASAPORTËS/DOKUMENT IDENTIFIKIMI _____
Passport Number/ Identification document

ADRESA E VENDBANIMIT _____
Residential Address

ZONA KUFITARE _____
Border Area

Kjo leje e kalimit kufitar lokal, është e vlefshme nga data dd.mm.yy deri më dd.mm.yy
This Local Border Traffic Permit is valid from ____ until ___

DREJTORI I DVKM
Director

_____

Nënshkrimi, Vula e Autoritetit